

# DOKUMENT UDHËZUES PËR APLIKANTË

NËN-GRANTE PËR FUQIZIMIN E ORGANIZATAVE MJEDISORE NË SHQIPËRI

KODI THIRRJES: 55130002

MODULI I GRANTIT TË RRJETËZIMIT, ADVOKIMIT DHE NDIKIMIT NË POLITIKBËRJE

## Tabela e përmbajtjes

1. NË LIDHJE ME “Green-AL” .....	3
2. ARSYETIMI DHE ANALIZA E KONTEKSTIT .....	4
3. OBJEKTIVAT & PRIORITETET .....	4
4. KRITERET PËR TË APLIKUAR NË KËTË THIRRJE.....	6
4.1 Ndarja territoriale:.....	6
4.2 Aplikantët.....	6
4.2.1 Aplikanti kryesor.....	7
4.2.2 Bashkë-aplikantët.....	7
4.2.3 Numri i aplikimeve për çdo modul: .....	8
4.3 Temat Potenciale.....	8
4.4 Llojet e aktiviteteve të lejuara:.....	10
4.5 Vizibiliteti .....	10
4.6 Perspektiva Gjinore.....	11
4.7 Kostot.....	11
4.8 Konsiderata .....	13
5. APLIKIMI DHE DOKUMENTAT E NEVOJSHËM .....	13
5.1 Afati i aplikimit.....	13
5.2 Dokumentacioni i nevojshëm.....	14
6. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE.....	15
6.1 Kontrolli Administrativ dhe Vlerësimi Paraprak i cili konsiston në:.....	15
6.2 Vlerësimi Cilësor/Përmbajtjesor i Aplikimit të Plotë .....	16
6.3 Procedura e përzgjedhjes.....	18

## Listë Akronimesh

<b>BE</b>	Bashkimi European
<b>CISP</b>	Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli
<b>Co-PLAN</b>	Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit
<b>COSV</b>	Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio
<b>OJF</b>	Organizatë JoFitimprurëse
<b>OJQ</b>	Organizatë JoQeveritare
<b>OSHC</b>	Organizata të Shoqërisë Civile
<b>R&amp;D</b>	Research & Development (Kërkim dhe Zhvillim)
<b>SIDA</b>	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim
<b>TIK</b>	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
<b>TVSH</b>	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
<b>VIS</b>	Volontariato Internazionale per lo Sviluppo

## 1. NË LIDHJE ME “GREEN-AL”

Green-AL është një projekt i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA) me fondet e Qeverisë Suedeze. Si një vijimësi e mbështetjes së Qeverisë Suedeze në fuqizimin e sektorit mjedisor dhe angazhimit civil, tanimë mbështetja e tyre vjen nëpërmjet programit Green-Albania (Green-AL) për zbatimin e të cilit është mandatuar:

- Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, me statusin “partneri lider”;
- CISP, “Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli”;
- VIS, “Volontariato Internazionale per lo Sviluppo dhe
- COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario,

**Synimi:** Mbështetje e drejtpërdrejtë në fuqizimin e kapaciteteve të OSHC mjedisore përgjatë periudhës **Tetor 2021 – Shtator 2023**, me një kontribut prej **785.000 Euro**, të cilat ofrohen në formën e granteve.

Konkretisht, Green-AL synon të ndihmojë OSHC-të mjedisore në dy nga përparësitë të cilat kërkon të adresojë ky projekt:

- fuqizimin tematik dhe administrativ të Organizatave të Shoqërisë Civile Mjedisore nëpërmjet procesit të inkubimit,
- mbështetjen financiare për të faktorizuar prezencën dhe influencën ndaj çështjeve mjedisore dhe rolin e tyre me aktorët lokal e qendror, kjo nëpërmjet moduleve të nën-granteve.

Për të ofruar asistencë direkte dhe të vazhdueshme OSHC-ve, territori i vendit është ndarë në 4 rajone:

- Rajoni Qendror, i cili përfshin qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier;

*(përfaqësuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit)*

- Rajoni Veri-Lindor, i cili përfshin qarqet Dibër dhe Kukës;

*(përfaqësuar nga CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli)*

- Rajoni Veri-Perëndimor, i cili përfshin qarqet Shkodër dhe Lezhë;

*(përfaqësuar nga VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo)*

- Rajoni Jugor, i cili përfshin qarqet Vlorë, Gjirokastrë, Korçë dhe Berat.

*(përfaqësuar nga COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario)*

Prezenca rajonale e Green-AL, mbështetja tematike dhe teknike e saj do të duhet të merret në konsideratë nga çdo aplikant apo partneritet. Ndërkohë, partneriteti Green-AL do të ofrojë në momentet e duhura të gjithë mbështetjen e drejtpërdrejtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e granteve fitues nëpërmjet, prezencës fizike në aktivitete të ndryshme si dhe asistencës teknike përgjatë të gjithë periudhës së implementimit të projektit.

## 2. ARSYETIMI DHE ANALIZA E KONTEKSTIT

Në kuadër të procesit të hapjes së negociatave për t'u integruar në BE, vendit i duhet një qasje gjithëpërfshirëse ku secili nga aktorët e përfshirë në këtë proces të luaj një rol aktiv për arritjen me sukses të këtij objekti. Përfshirja e Shoqërisë Civile në këto procese është një hap sa i nevojshëm aq dhe i domosdoshëm i cili mbështetet edhe nga 'Udhërrëfyesi për politikën e qeverisë drejt një mjedisi më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile -2019 -2023' në tre nga prioritetet e saj:

- Përfshirja e qëndrueshme dhe efektive e OSHC-ve në proceset e hartimit të politikave në politikë-bërje dhe integritet në BE;
- Sigurimi i kontributit të OSHC -ve në procesin e pranimit të Shqipërisë në BE në përputhje me praktikën e mira BE-së;
- Mbështetja e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive me fokus të veçantë në nivelin lokal.

Në këtë drejtim ngritja apo fuqizimi i rrjeteve të OSHC-ve mjedisore me fokus ngritjen e çështjeve mjedisore e përfshirjen aktive në proceset politikbërëse është një element tepër i rëndësishëm i zhvillimit të OSHC-ve në veçanti por dhe i shoqërisë në përgjithësi.

Krijimi i një rrjeti konsiderohet të ketë përfitime duke qenë se i jep çështjes apo problematikës së ngritur efekt amplifikues, rrit gjithë-përfshirjen duke marrë në konsideratë edhe mendimin e organizatave të vogla lokale, mundëson akses më të madh në burime financiare dhe ekspertizë, rrit shkallën e ndërveprimit, rrit vizibilitetin duke arritur një numër më të madh qytetarësh dhe institucionesh si dhe i jep legjitimitet anëtarëve të rrjetit dhe çështjes që ata ngrenë.

Në vendin tonë, në vitin 2019, janë identifikuar rreth 27<sup>1</sup> rrjete ku një pjesë rezultojnë të regjistruar zyrtarisht e një pjesë tjetër veprojnë në mënyrë joformale, këto rrjete kanë në fokus të veprimtarisë së tyre Çështjet e të Rinjve dhe të Drejtat, Qeverisjen e Mirë dhe të Drejtat e Njeriut me 15% për tu ndjekur nga Çështjet Mjedisore dhe të Drejtat e Grave me 11% të rasteve.

Në këtë kuadër projekti Green-AL mbështet zhvillimin, krijimin dhe forcimin e rrjeteve të OSHC-ve mjedisore, ndërmjet tyre apo me grupe të tjerë interesi, për të mundësuar ndarjen e njohurive e praktikave të mira për të ndikuar në faktorizimin e shoqërisë civile si ofruesin e një mendimi alternativ e të besueshëm të progresit të bërë në sektorin e mjedisit. Si dhe për të rritur kapacitetet e OSHC-ve mjedisore për të qenë pjesë aktive e proceseve politikbërëse dhe adresimin e çështjeve mjedisore duke përcjell zërin qytetar dhe ngritjen e problematikave lokale e rajonale në nivel kombëtar për të *advokuar* për ligje e politika më të mira në sektorin e mjedisit.

## 3. OBJEKTIVAT & PRIORITETET

Qëllimi i kësaj thirrje është fuqizimi i OSHC-ve për të adresuar problematikën që lidhen me mjedisin natyror dhe urban në nivel lokal, përmes rrjetëzimit, advokimit dhe ndikimit në proceset politikbërëse në nivel rajonal dhe kombëtar.

<sup>1</sup> Hartëzimi dhe vlerësimi i rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri, Raport Vlerësimi, Tiranë 2019. Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.

### **3.1 Prioritetet:**

- a. Mbështetja e OSHC-ve për ndërtuar e fuqizuar rrjetëzimin ndërmjet tyre dhe me grupe të tjera interesi për të ngritur e adresuar çështje mjedisore;
- b. Rritja e fuqisë *advokuese* dhe monitoruese të OSHC-ve mjedisore për të promovuar mbrojtjen e mjedisit dhe për të rritur të drejtën për informacion mbi procesin e vendimmarrjes që ndikon në mjedis.

### **3.2 Objektivat Specifik:**

- a. Krijimi i 6 Rrjeteve Rajonale, 1 për rajonin Veri-Lindor, 1 për rajonin Veri-Perëndimor, 2 për rajonin Qendror dhe atë Jugor;
- b. Krijimi i 4 Rrjeteve Kombëtare;
- c. Konsolidimi i praktikave të rrjetëzimit si një mënyrë efektive për të ngritur problematikat mjedisore në një nivel më të lartë;
- d. Shkëmbimi i praktikave të mira ndërmjet rrjeteve dhe grupeve të interesit në ngritjen dhe adresimin e problematikave mjedisore;
- e. Fuqizimi OSHC-ve mjedisore për tu bërë pjesë aktive e proceseve politikbërëse në sektorin e mjedisit;
- f. Zbatimi i fushatave të komunikimit dhe *advokimit* për të ngritur ndërgjegjësimin e komunitetit dhe ushtruar presion pozitiv drejt organeve politikbërëse dhe ligj-zbatuese në funksion të mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit;
- g. Zhvillimi i dokumenteve të politikave;
- h. Vlerësimi dhe rishikimi i politikave;
- i. Hartimi i raporteve analitike për reforma sektoriale apo politikbërjen në një sektor;
- j. Zhvillimin e debateve publike me fokus *advokimin*.

### **3.3 Mbështetja financiare**

**Vlera totale e vënë në dispozicion për këtë thirrje është 430,000 EURO.** Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të mos akorduar të gjithë shumën e vënë në dispozicion nëse nuk ka një numër të mjaftueshëm propozimesh apo nëse ato nuk janë në cilësinë e duhur për tu shpallur fitues.

Çdo grant i kërkuar në këtë thirrje duhet të akomodohet brenda limiteve minimale apo maksimale të mëposhtme, varësisht aktiviteteve apo produkteve që organizatat planifikojnë për të realizuar qëllimin e projekt-propozimit.

MODULI	VLERE E GRANTIT (EURO)	KOHËZGJATJA (MUAJ)	APLIKUESI	AKTORË / PARTNERË
Rrjetet Rajonale (max.6)	10.000- 31,000	10-18 Muaj	Organizatë e Shoqërisë Civil Mjedisore (+ të paktën 2 OSHC anëtarë/partnerë )	Organizata të reja lokale, organizata lokale ( <i>grassroots</i> ), grupime formale e informale, qytetarë, përfaqësues të biznesit, institucione arsimore, institucione publike.
Rrjetet Kombëtare (max. 4)	40.000 – 60.000	10- 18 Muaj	Organizatë e Shoqërisë Civil Mjedisore (+ të paktën 2 OSHC anëtarë/partnerë )	Organizata të reja lokale, organizata lokale ( <i>grassroots</i> ), grupime formale e informale, qytetarë, përfaqësues të biznesit, institucione arsimore, institucione publike.

Në të dy rastet lejohet kryerja e investimeve **deri në 25% të buxhetit** total të kërkuar. Mos parashikimi i kryerjes së investimeve nuk është kriter dëmtues.

#### 4. KRITERET PËR TË APLIKUAR NË KËTË THIRRJE

Kriteret për te aplikuar në këtë thirrje, janë ndarë në 4 kategori, si me poshtë:

##### 4.1 Ndarja territoriale:

Referuar ndarjes territoriale sipas projektit Green-AL.:

- organizatat të cilat synojnë të aplikojnë për të qenë pjesë e Rrjeteve Rajonale nëpërmjet kësaj skeme granti, duhet fillimisht të jenë të pozicionuara nga zona ku aplikojnë dhe/ose (*në mungesë të aplikantëve nga rajoni*) të përqendrojnë veprimtarinë e tyre në rajonin në të cilin aplikojnë si dhe të kenë legjitimitet të plotë të përfaqësimit të komuniteteve dhe të çështjeve mjedisore brenda qarkut apo rajonit. Rrjetet Rajonale do të duhet të bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë me organizatat fituese në Grantet e Iniciativës dhe Partneritetit.
- organizatat të cilat aplikojnë për Rrjetet Kombëtare do të përqendrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e vendit por në varësi edhe të tematikës së zgjedhur duhet të marrin në konsideratë çështjet e ngritura nga rrjetet rajonale për ti ngritur ato në një nivel më të lartë diskutimi.

##### 4.2 Aplikantët

- “Aplikanti kryesor”: organizatë e shoqërisë civile ( OSHC) me fokus në çështje mjedisore; dhe
- “Bashkë-aplikantët”: organizata të shoqërisë civile.

Në këtë thirrje, aplikantët duhet të formojnë një partneritet i cili minimalisht duhet të jetë i përbërë nga **1 OSHC** (në cilësinë e aplikantit kryesor) **dhe 2 OSHC**, në cilësinë e Bashkë-aplikantit.

Ky është një kusht i cili duhet të plotësohet në të gjitha partneritetet të cilat do të aplikojnë në këtë thirrje. Aplikantët mund të zgjedhin të bashkëpunojnë dhe të përfshijnë në partneritet edhe partnerë të tjerë të cilat janë listuar mëposhtë në pikën 4.2.2.

#### 4.2.1 Aplikanti kryesor

Aplikanti kryesor (lideri) në Rrjetet Kombëtare dhe Rajonale duhet të përmbush kriteret e mëposhtme për të aplikuar:

1. Të jetë Organizatë jofitimprurëse (OJF) e regjistruar sipas ligjit nr. 8788 dates 07.05.2011 “Për organizatat jofitimprurëse”;
2. Të jetë organizatë që ka në fokusin e saj mjedisin dhe mbrojtjen e promovimin e habitateve;
3. Të ketë minimalisht 3 vite eksperiencë në rast se do të aplikojë për Rrjetet Rajonale (3 vite nga regjistrimi në Gjykatë);
4. Të ketë minimalisht 5 vite eksperiencë në rast se do të aplikojë për Rrjetet Kombëtare (5 vite nga regjistrimi në Gjykatë);
5. Eksperienca të mëparshme pune apo angazhimi në rrjete tematike do të konsiderohet vlerë e shtuar;
6. Të mos ketë konflikt interesi me asnjë nga organizatat partnere të Green-AL si edhe mbivendosje të aktiviteteve me projekte që janë ende nën marrëdhënie kontraktuale. Nëse gjatë zbatimit të marrëveshjes lind ndonjë konflikt interesi, përfituesi duhet të njoftojë menjëherë organizatën Grant-dhënëse.

Aplikanti kryesor do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e projekt propozimit. Aplikanti kryesor do të jetë përgjegjës për nënshkrimin e kontratës së grantit, në rast se shpallet fitues, si edhe përgjegjës i drejt-për-drejtë për menaxhimin e projektit së bashku me bashkë-aplikantët dhe jo të ndërveproj si ndërmjetësues:

**E rendesishme:** Aplikanti kryesor duhet të ketë një marrëveshje partneriteti me shkrim me Bashkë-aplikantët e projektit. Në marrëveshje duhet të specifikohet roli specifik i gjithsecilit prej partnerëve.

#### 4.2.2 Bashkë-aplikantët

Në këtë thirrje për të formuar një partneritet të suksesshëm duhet të përfshihen medoemos 2 OSHC.

Bashkë-aplikanti(ët) duhet të përmbushin kriterin e mëposhtme për të aplikuar:

- Të jetë Organizatë jofitimprurëse (OJF) e regjistruar sipas ligjit nr. 8788 datë 07.05.2011 “Për organizatat jofitimprurëse”.

**Opsionale.** Nëse aplikanti e konsideron vlerë të shtuar mund të përfshij në partneritet, pa buxhet, një apo disa nga aktorët listuar më poshtë:

- a. *Organizime apo grupime jo-formale rinore, kulturore, gjinore, etj.;*
- b. *Departamente nga Fakultete Publike dhe Private;*
- c. *Institute Kërkimore e Arsimore;*

- d. *Operatorë ekonomik;*
- e. *Institucione publike si Bashki, Njësi Administrative etj.;*
- f. *Agjenci Rajonale apo Kombëtare etj..*

Në të gjitha rastet roli Aplikantit kryesor dhe Bashkë-aplikantëve duhet të dali qartë në projekt propozim.

#### 4.2.3 Numri i aplikimeve për çdo modul:

- a) Aplikantët të cilët duan të jenë aplikant-kryesor të Rrjeteve qofshin ato Rajonal apo Kombëtar mund të jenë vetëm 1 (një) herë të tillë dhe nuk kanë të drejtë të ri-aplikojnë si Bashkë-aplikant në asnjë prej Rrjeteve.
- b) Organizatat të cilat duan të aplikojnë si Bashkë-aplikant në Rrjetet Rajonale apo Kombëtare mund të aplikojnë deri në 2 (dy) herë si të tillë. Ato mund të zgjedhin të jenë dy herë partner në Rrjetet Rajonale, Rrjetet Kombëtare apo një kombinim i të dyjave.
- c) Aktorët me të cilat OSHC-të mund të lidhin partneritet (listuar në 4.2.2) mund të aplikojnë vetëm 1 (një) herë si partner në një nga dy tipologjitë e Rrjeteve.

**E rëndësishme:** Organizatat lider përfituese të granteve të Partneritetit, **nuk mund të aplikojnë në këtë thirrje.** Nga ana tjetër organizatat fituese të granteve të Iniciativës dhe partnerët tek grantet e Partneritetit **mund të përfshihen si bashkë-aplikantë në këtë thirrje vetëm 1 (një) herë.**

#### 4.3 Temat Potenciale

Green-AL sugjeron që aplikuesit t'i referohen dhe të adresojnë temat e pasqyruara më poshtë si dhe në referencë me dokumentin e Vlerësimit të Nevojave-Needs Assessment Report (temat do të trajtohen më në detaj gjatë sesioneve informuese).

Nga ana tjetër, nuk do të jetë dëmtues fakti që një organizatë paraqet një aplikim i cili sjell risi apo është mëse aktual për rajonin në të cilin aplikon apo edhe në nivel kombëtar dhe nuk është një përsëritje apo riciklim i pastër i projekteve të mëparshme.

Të gjithë rrjetet duhet të kenë një profil tematik mbi të cilin do të ndërtojnë propozimin e tyre dhe rrjedhimisht aktivitetet e parashikuara do të sjellin një rezultat të matshëm pikërisht për tematikën e përzgjedhur. Në të gjitha rastet, Green-AL do të vlerësoj maksimalisht aksione apo ndërhyrje praktike përkundrejt qasjeve të përgjithshme apo teorike të problematikës. Propozimi juaj duhet të ndikojë në orientimin e duhur dhe drejt zgjidhjes të problemit mjedisor tematik që do të adresoni.

Disa sugjerime lidhur me orientimin tematik të propozimit dhe partneritetit tuaj mund ti gjeni si më poshtë:

- Koalicioni për Kapitullin 27:

Këtu mund të synohet të adresohet / analizohet një apo një grup prej nën-kapitujve të kapitullit 27 sa i takon nivelit të përafrimit, zbatimit të direktivave si edhe mungesa e kapaciteteve të nevojshme për zbatimin e tyre. Pa harruar implikimet që mund të sjell në nivel lokal zbatimi i këtyre politikave.

- Rrjeti për Cilësinë e Ajrit:



Këtu mund të synohet qartësisht monitorimi, sensibilizimi dhe ndikimi në politikbërje për një apo një grup të ndotësve të ajrit urban. Sikundër mund edhe të jetë një rrjet i dedikuar që merret specifikisht me gjurmimin e ndotjes nga një sektor specifik.

- Rrjeti për Shërbimet e Ekosistemit Urban apo Natyror;

Këtu mund të synohet si vlerësimi sasior apo cilësor i këtyre shërbimeve në një zonë apo habitat të caktuar, por mund të jetë edhe ngritja e një metodologjie vlerësimi e cila do i shërbente autoriteteve lokale e qendrorë në proceset e tyre vendim-marrëse.

- Rrjeti për Menaxhimin e Mbetjeve;

Sugjerohet si tematikë për rrjetet rajonale ku të adresohen çështje praktike për përmirësimin e modelit apo alternativave të menaxhimit të mbetjeve në tërësi apo të një rryme të caktuar. Sikundër mund të jetë me rëndësi edhe ndërgjegjësimi i modeleve ekzistuese të biznesit dhe komuniteteve në raport me menaxhimin e mbetjeve. Këshillohet që këto rrjete të jenë në kohezion me strategjitë lokale, rajonale dhe kombëtare të menaxhimit të mbetjeve por pa limituar të drejtën e përdorimit të parimeve bazë në hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve.

- Rrjeti i Veprimit ndaj Ndryshimeve Klimatike;

Mund të punohet me sektorë të veçantë si uji, menaxhimi risqeve nga ndikimet klimatike, bujqësia etj. duke synuar mbështetjen ndaj autoriteteve lokale në përgatitjen e tyre tematike dhe teknike në raport me përballimin e këtyre risqeve të mundshme.

- Rrjeti për Eficiencë dhe Energji të Rinovueshme;

Mund të punohet në nivel rajonal për të identifikuar mundësi reale në funksion të rritjes së eficiencës të shërbimeve publike të cilat konsumojnë energji sikundër edhe evidentimi i potencialeve që disa autoritete lokale mund të kenë për të shfrytëzuar energjinë e rinovueshme duke e bërë pjesë të planeve të përgjithshme vendore. E njëjta qasje mund të vij edhe në nivel kombëtar ku ndër të tjera mund të adresohet autonomia energjitike për qytetarët që duan të vet-prodhojnë energji etj.

- Rrjeti për Mbrojtjen e Habiteteve të Biodiversitetit;

Nën këtë tematikë rrjetet mund të fokusohen si në nivel rajonal por edhe në nivel kombëtar duke qenë se subjekt i kësaj teme mund të jenë si politikat kombëtare të menaxhimit të tyre por edhe ato rajonale ku tipologjia e zonave të mbrojtura dhe biodiversiteti lidhet me territorin (detar, fushor, kodrinor apo malor).

**Vini re!** Tematikat e lart-përmendura janë thjesht disa nga sugjerimet dhe orientimet që projekti Green-AL jep duke u bazuar në raportin e Vlerësimit të Nevojave, përtej këtyre mund të ketë tema edhe më specifike apo aktuale të cilat mund të jenë subjekt aplikimi nga ju por gjithmonë duke parashtruar motivimin dhe argumentimin e duhur përse kenë zgjedhur një temë ndryshe nga të mësipërmet.

## ME RËNDËSI TË VEÇANTË:

- a. **Trajtimi tematik që pritet nga rrjetet rajonale duhet patjetër të jetë i fokusuar në çështje të cilat janë nën përgjegjësinë e autoriteteve lokale apo rajonale.**
- b. **Rrjetet kombëtare nga ana tjetër duhet të ndërtojnë qasjen për temën e tyre në mënyrë që të influencojnë politika në nivel qendror.**

#### 4.4 Llojet e aktiviteteve të lejuara:

Në këtë thirrje, pritet që OSHC-të të aplikojnë qasjet e mëposhtme (kjo listë nuk është shteruese):

- a. Të përfshihen në procesin dhe dialogun me politikë-bërësit lokal/rajonar/kombëtar;
- b. Të angazhojnë dhe mbështesin komunitetet apo grupimet e ndryshme në kërkesat e tyre për një mjedis të shëndetshëm apo në mbrojtje të habitatit;
- c. Të prezantojnë modele inovative në menaxhimin dhe monitorimin e mjedisit në nivel lokal/rajonar/kombëtar;
- d. Të përdori mjete komunikimi tradicionale dhe novatore për të ndikuar në adresimin e problematikës së ngritur;
- e. Të *advokojnë* alternativën më të mirë për zgjidhjen e çështjes mjedisore;
- f. Të mbështesë iniciativa e praktika të suksesshme në kuadër të mbrojtjes, promovimit dhe bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e mjedisit;
- g. Të ofrojnë alternativa për zgjidhjen e problematikës së ngritur nëpërmjet hartimit të dokumenteve/letrave të pozicionimit;
- h. Të mbështesin kërkimin dhe raportimin të bazuar në fakte dhe të dhëna nga terreni.

**Shënim:** Përdorni referenca eksplicite nga udhëzuesi kur ndërtoni një aktivitet apo ndërhyrje të bazuar mbi rekomandimet e këtij dokumenti.

#### Aktivitete të palejueshme:

- Aktivitete që kanë të bëjnë me financimin e individëve për të marrë pjesë në seminare, konferenca dhe kongrese për qëllime personale nuk janë të lejueshme;
- Investime në pronë apo favor të subjekteve private nuk janë të lejueshme.

#### 4.5 Vizibiliteti

Green-AL sugjeron aplikantët në thirrjen për grantet e **Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje** që në propozimet e tyre të krijojnë hapësirën e nevojshme për përfshirjen e një personi të dedikuar që do të merret me komponentin e komunikimit nëse projekt ideja juaj do të shpallet fituese. Kështu, theksojmë se komponenti i komunikimit në tërësi është i rëndësishëm për qasjen që Green-AL ka ndaj propozimeve. Për të arritur një audiencë më të gjerë dhe amplifikuar mesazhin, rezultatet e aktiviteteve dhe arritjeve të projektit tuaj, Green-AL mbështet bashkëpunimin me median e shkruar dhe *audio-vizuale* qoftë ajo lokale, rajonale apo kombëtare.

**E rëndësishme:** Varësisht dhe në përputhje me zbatimin e politikave për parandalimin dhe/ose zbutjen e përhapjes së COVID-19, në çdo rast, aktivitetet e propozuara do duhet të marrin në konsideratë kufizimet e mundshme dhe të propozojnë mënyra alternative të lejuara për të siguruar vazhdimësinë dhe zbatimin me efikasitet të plotë të aktiviteteve të parashikuara.

Në varësi edhe të projekt idesë e çështjes që ju kërkoni të adresoni mjete/materiale vizibiliteti konsiderohen, por nuk kufizohen në:

- **Rjete sociale**, përdorimi i rrjeteve sociale si *Facebook, Instagram, You-tube* jan kthyer tanimë si një mjet alternativ tepër eficient për promovimin e aktiviteteve të projektit dhe projektit në vetvete, për këtë arsye në do të sugjeronim përdorimin e rrjeteve sociale ekzistuese të organizatës apo partnerëve të rrjetit;
- **Broshura** fletë palosje në format digjital, me mesazhe specifike në varësi të çështjes që ju ngrini.;
- **Produkte digjitale** si video, info-grafikë, reportazhe etj.

## 4.6 Perspektiva Gjinore

Partnerët e projektit Green-AL dhe Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA) e konsiderojnë barazinë gjinore si një komponent thelbësor për të kontribuar në arritjen e qëllimeve mjedisore dhe për të fuqizuar ripërtëritjen ndaj impakteve të ndryshimeve klimatike.

Në këtë drejtim Green-AL kërkon që aplikantët të përfshijnë perspektivën gjinore në projekt propozimet të cilat do të paraqiten në kuadër të kësaj thirrje. Green-AL synon të sigurojë integrimin gjinor në të gjitha ose pjesën më të madhe të aktiviteteve të mbështetura nga ky projekt, ku përfituesit e granteve kanë mundësinë që të sjellin projekte dhe nisma që i përgjigjen më së miri nevojave dhe mundësive të ndryshme të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave për sa i përket mbrojtjes së mjedisit. Për të mbështetur adresimin sa më të mirë të çështjeve gjinore Green-AL do të kontraktoj një ekspert/e gjinor i/e cili/a do të asistojë përfituesit e granteve. Për këtë arsye të gjithë përfituesit e granteve në kuadër të projektit Green-AL do të duhet të bashkëpunojnë dhe reflektojnë kontributin e ardhur nga eksperti/ja gjinor/e gjatë aplikimit të projektit të tyre.

Sugjerojmë që gjatë hartimit të projekt propozimeve të merren në konsideratë elementë të tillë si:

- Në aktivitete të tilla si konsultime, tavolina të rumbullakëta, aktivitete ndërgjegjësimi të ketë një pjesëmarrje minimale 30% nga secila gjini;
- Të shqyrtohet impakti që çështja e ngritur nga ju, ka mbi burrat dhe gratë;
- Produktet dhe materialet e prodhuara nga projekti, të janë të ndjeshme ndaj gjinisë.

## 4.7 Kostot

Vetëm "kostot e pranueshme" mund të merren parasysh për një grant. Kategoritë e kostove të konsideruara si të pranueshme dhe jo të pranueshme paraqiten si më poshtë. Vini re, se kostot e pranueshme duhet të bazohen në kosto reale referuar në dokumentet mbështetëse.

Rekomandimet për dhënien e një granti gjithmonë i nënshtrohen një procesi të kontrollit para nënshkrimit të kontratës. Procesi i kontrollit ka për qëllim të nxjerrë në pah probleme që kërkojnë ndryshime në buxhet (për shembull gabime aritmetike, pasaktësi ose kosto jo reale dhe kosto të tjera të papranueshme).

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit mund të bëjë modifikime ose ulje në shumën e grantit të kërkuar, në rast se vërehen gabime ose pasaktësi të tilla. Shuma e grantit, si rezultat i këtyre

korrigjimeve, nuk mund të rritet, për këtë arsye është në interesin e aplikantit të sigurojë një buxhet realist dhe me kosto efektive.

### **Kosto të pranueshme**

Kostot e pranueshme janë ato kosto që:

- a. janë zhvilluar gjatë zbatimit të aktiviteteve siç specifikohet në kontratë. Kjo do të thotë që kostot kanë të bëjnë me aktivitetet e kryera gjatë periudhës së zbatimit;
- b. pasqyrohen në buxhetin e përgjithshëm të aktivitetit (në formatin e aneksuar të buxhetit);
- c. janë të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve;
- d. mund të gjurmohen dhe verifikohen në origjinë, veçanërisht të regjistruara në regjistrat kontabël të Përfituesit të Grantit dhe të përcaktuara në përputhje me standardet e zbatueshme të kontabilitetit të Republikës së Shqipërisë;
- e. janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm tatimor;
- f. respektojnë rregullat e kombësisë dhe origjinës.

### **Janë të pranueshme kostot e mëposhtme nga Përfituesi i Grantit:**

- kostot e stafit të caktuar në projekt-propozim, që korrespondojnë me pagat aktuale bruto duke përfshirë tarifën e sigurimeve shoqërore dhe kostot e tjera të lidhura me shpërblimin;
- shpenzimet e udhëtimeve dhe dietave për personelin dhe personat e tjerë që marrin pjesë në projekt, me kusht që të jenë kosto reale të konfirmuara nga dokumente mbështetëse;
- kostot e blerjeve për pajisje (të reja ose të përdorura) dhe shërbime të posaçme për qëllimet e projektit. E aplikueshme vetëm në rastin e Rrjetëve Rajonale.

**E rëndësishme:** Vini re se taksat, përfshirë TVSH-në do të aprovohen si kosto të pranueshme vetëm kur të plotësohen kushtet e mëposhtme (dhe të konfirmuara nga dokumentet mbështetëse):

- Taksat e vlerës së shtuar nuk janë të rimbursueshme në asnjë mënyrë;
- Sipas praktikës, ato do të përballohen nga përfituesi; dhe
- Ato pasqyrohen qartë në projekt propozim.

### **Kosto të papranueshme:**

Kostot e mëposhtme nuk do të konsiderohen të pranueshme:

- borxhe dhe tarifën e shërbimit të borxhit (interesat);
- dispozita për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;
- kosto të deklaruara nga Përfituesi dhe të financuara nga donatorë ose nga veprime të tjera të financuara nga Sida;
- humbjet e këmbimit valutor;
- kredi për palët e treta;
- kostot e pagave të personelit të administratës shtetërore, publike.

## 4.8 Konsiderata

**Konsiderata në nivel social:** Duke qenë se çështjet mjedisore kanë një dimension social, të tilla si: reformat aktuale lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në BE, niveli i ulët i bashkëveprimit ndërmjet OSHC-ve për të promovuar mbrojtjen e mjedisit në një njësi të caktuar territoriale përtej jetëgjatësisë së një projekti, etj. Sugjerojmë që aplikantët të përfshijnë në propozimin e tyre persona dhe procese të përpunimit grafik të informacioneve të cilat do të ndihmojnë në përgatitjen e produkteve si: raporte teorike dhe teknike, letra pozicionimi, ndryshime të propozuara në legjislacion etj., por nga ana tjetër do të ndihmojnë zbatuesit e projektit të hartojnë materiale të cilat janë lehtësisht të kuptueshme nga qytetarët dhe komuniteti në përgjithësi, nëpërmjet info-grafikëve, lajmeve në media, vizitave në terren, etj.

**Konsiderata në nivel mjedor:** Çdo aplikim duhet të shmangë përdorimin e plastikës<sup>2</sup> një-përdorimesh në çdo aktivitet apo produkt të saj, në rast të kundërt kostot nuk do të mbulohen nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë produktet, të lidhura me printimet nga ky projekt duhet të jenë miqësore me mjedisin ose materiale të ripërdorura, të ricikluara, aty ku është e mundur. Për këtë arsye Green-AL sugjeron që printimet në masë (mbi 30 fletëpalosje) apo raporte të cilat janë voluminoze (mbi 30 faqe) të shihet mundësia për të përdorur material (letër) të ricikluar.

**Konsiderata në nivel akademik dhe institucional:** Në të gjitha rastet, efektet e ndërhyrjes duhet të jenë të matshme dhe të prekshme. Duke qenë se do të lejohen investime në masën 25% të buxhetit total, ndërhyrjet konkrete (që nga parandalimi dhe mbrojtja e mjedisit, ekspeditat kërkimore, monitorimi mjedisit dhe deri në ndërhyrje të drejtpërdrejta) duhet të adresojnë gjithnjë një nevojë apo të mirë publike. Sikurse mund të jetë edhe mbështetja në përmbushjen e një detyrimi ligjor të lidhur me mjedisin nga ana e institucioneve lokale.

## 5. APLIKIMI DHE DOKUMENTAT E NEVOJSHËM

### 5.1 Afati i aplikimit

**Afati i pranimit të aplikimeve: e Hënë 31 Janar 2022, ora 16:00).**

Aplikantët në këtë thirrje duhet të dërgojnë në adresën e Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit: [co-plan@co-plan.org](mailto:co-plan@co-plan.org) dokumentet e kërkuara në këtë udhëzues vetëm në formatin elektronik.

Sugjerojmë të gjithë palët e interesuara të shmangin dorëzimin në momentin e fundit pasi mund të ketë mbingarkesa të sistemit operativ dhe çdo dorëzim i regjistruar nga sistemi ynë pas orës 16.00 nuk do të trajtohet nga Komisioni i Vlerësimit.

Për sqarime më të detajuara, të gjithë aplikantët ftohen të marrin pjesë në takim orientues mbi procesin e aplikimit në datën **16/12/2021**, Agjenda dhe kredencialet e këtij takimi do të publikohen në ditët në vijim.

<sup>2</sup> Gjatë organizimit të trajnimeve, takimeve me komunitetin etj. Aplikantët nuk duhet të (shmangin në maksimumin e mundshëm) përdorin produkte njëpërdorimshe të plastikës të tilla si gota plastike, apo shishe uji plastike. Gjatë organizimit të këtyre eventeve aplikantët duhet të specifikojnë në faturat e shërbimit dhe dokumentojnë me foto faktin që kanë përdorur materiale alternative.

**Aplikimi do të konsiderohet i vlefshëm vetëm nëse është dërguar brenda ditës dhe orarit të përcaktuar.**

Një komunikim me e-mail do t'i dërgohet secilit prej aplikantëve për të konfirmuar marrjen dhe vlefshmërinë paraprake të aplikimit. Ndonëse ky nuk është një kriter skualifikues, për lehtësi komunikimi, do t'ju inkurajonim që në tërësi dosja elektronike e aplikimit e cila do të dërgohet me e-mail, të mos tejkalojë 4Mb sikundër duhet të keni parasysh që server në rast se të gjithë aplikantët dërgojnë materialet e tyre në fund të afatit mund të bllokohet.

### **Takime orientuese:**

#### **Partneriteti Green-AL do të organizojë 2 takime orientuese:**

- 1 takim i cili do të zhvillohet në datë **16/12/2021** dhe do të shërbejë për të orientuar të gjithë të interesuarit për të aplikuar në grantet e Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Politikbërje, i cili do të zhvillohet gjatë periudhës që thirrja është ende e hapur.
- 1 takim për të orientuar fituesit e këtyre granteve mbi kërkesat lidhur me raportimin, buxhetin, vizibilitetin etj.

### **5.2 Dokumentacioni i nevojshëm**

Aplikimet për projekt-propozime duhet të dorëzohen në përputhje të plotë me përcaktimet e këtij dokumenti udhëzues. Aplikantët duhet të përgatisin dhe të dorëzojnë aplikimet e tyre në gjuhën shqipe, me një përmbledhje me 300 fjale në gjuhën Angleze (pjesë integrale e Formularit të Aplikimit).

Çdo gabim apo mospërputhje në lidhje me pikat e renditura në udhëzim për formularët e aplikimit (p.sh. mospërputhje shumash në buxhetin e dorëzuar, mospërputhje midis aktiviteteve, burimeve dhe buxhetit) mund të rezultojnë në refuzim të aplikimit.

Sqarime do të kërkohen vetëm kur informacioni i dhënë është i paqartë në pikën që pengon Komisionin Vlerësues dhe Co-PLAN (në pozicionin e Autoritetit Kontraktues) të bëjë një gjykim objektiv.

#### **Dokumente Tip të Aplikimit:**

- Formati i aplikimit narrativ (Aneks 1);
- Formati i buxhetit/financiar (Aneksi 2);
- Formati i kornizës logjike (Aneksi 3)

#### **Dokumente mbështetës të kërkuar:**

1. Vendim i regjistrimit në gjykatë (kopje);
2. Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës (kopje);
3. Regjistrimi në zyrën e Tatim-Taksave, NIPT (kopje);
4. Profili Organizativ ku evidentohet qartë përvoja e punës në fushën e mjedisit (CV e organizatës);
5. CV e ekspertëve kyç të cilët do të përfshihen në projekt;
6. Marrëveshje bashkëpunimi në të cilën të evidentohet roli i secilit prej partnerëve.

**E rëndësishme:** Sigurohuni që po dorëzoni të gjitha dokumentet mbështetëse. Aplikimet e paplota dhe që nuk plotësojnë rregullat e vendosura, do të refuzohen.

## 6. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE

Një Komision i dedikuar do të ngrihet posaçërisht me vendim të brendshëm nga Co-PLAN, anëtarët e të cilit do të mandatohen për të siguruar një vlerësim objektiv, të paanshëm dhe profesional, ndaj projekt – propozimeve të paraqitura.

Vlerësimi është planifikuar të kalojnë në 3 faza të brendshme nga autoriteti kontraktues:

### 6.1 Kontrolli Administrativ dhe Vlerësimi Paraprak i cili konsiston në:

- *Hapjen e aplikimit*
- *Regjistrimin e detajuar të materialeve pjesë e aplikimit*
- *Vlerësimin e vlefshmërisë së tyre*

Përgjatë vlerësimit paraprak, më në detaj do të kontrollohen:

<i>Kriteret Administrative</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Komente</i>
1. Propozimi është dorëzuar brenda afatit dhe rregullave.			
2. Aplikimi ka respektuar formatin e kërkuar. (A janë plotësuar të gjitha pikat në format)			
3. Propozimi është në gjuhën shqipe dhe shoqërohet nga një përmbledhje në gjuhën angleze.			
4. A është aplikanti me vendodhje në rajonin ku po aplikon? (Vetëm në rastin e Rrjeteve Rajonale) ( <i>kriter i diskutueshëm</i> )			
<i>Dokumentet Mbështetës</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Komente</i>
1. Vendimi i regjistrimit në gjykatë ( <i>kopje elektronike</i> )			
2. Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës ( <i>kopje elektronike</i> )			
3. Regjistrimi në Zyrën e Tatim-Taksave (NIPT) ( <i>kopje elektronike</i> )			
4. Profili Organizativ ku evidentohet qartë përvoja e punës në fushën mjedisit. CV e organizatës			
5. CV e ekspertëve kyc të brendshëm e të jashtëm, të cilët do të përfshihen në projekt. ( <i>kriter i opsional</i> ).			
6. Memorandumi i Bashkëpunimit.			

<i>Buxheti, kohëzgjatja dhe nr. i aplikimeve</i>			
1. Buxheti total i projektit është brenda limiteve të kërkuara			
2. Kohëzgjatja e projektit është nga 10 deri ne 18 muaj			
3. Aplikuesi ka paraqitur vetëm një aplikim ( <i>ose si Aplikues, ose si Bashkë-Aplikues</i> ).			
4. A është formuar rrjeti me të paktën 3 OSHC? (1 lider OSHC mjedisore dhe 2 OSHC të tjera)			

Procesi i vlerësimit të granteve do të vazhdojë vetëm për aplikantët të cilët kanë kaluar fazën e kontrollit të parë. Të gjithë ata aplikantë të cilët nuk plotësojnë kërkesat e sipërpërmendura do të s’kualifikohen dhe respektivisht do të njoftohen.

## 6.2 Vlerësimi Cilësor/Përmbajtjesor i Aplikimit të Plotë

Cilësia e aplikimeve, duke përfshirë buxhetin e propozuar dhe kapacitetin e aplikantëve, do të vlerësohet duke përdorur kriteret e vlerësimit të plotë që janë në tabelën më poshtë me reference seksionet e formatit të aplikimit:

<b>Relevanca</b>	<b>Rezultati maksimal (pikë)</b>
<b>1. Kapaciteti operacional / teknik</b>	<b>Referenca me Propozimin Kap. 8</b>
<i>A ka aplikanti ekspertizë të mjaftueshme tematike (veçanërisht njohuri për çështjet që do të adresohen në lidhje me mjedisin)?</i>	5 (pikë)
<i>A ka aplikanti kapacitet të mjaftueshëm menaxhues (përfshirë stafin e brendshëm dhe të jashtëm, dhe aftësinë për të trajtuar buxhetin për aktivitetet e parashikuara)?</i>	5 (pikë)
<b>2. Rëndësia e veprimit</b>	<b>Referenca: Kap. 4</b>
<i>Sa i rëndësishëm është propozimi për adresimin, trajtimin apo zgjidhjen e çështjes mjedisore në rajonin përkatës apo në nivel kombëtar?</i>	<b>10 (pikë)</b>
<i>Sa qartë janë përcaktuar dhe zgjedhur strategjikisht ata që janë përfshirë (përfutuesit përfundimtarë, grupet e synuara, si do të afrohen dhe përfshihen aktorët)?</i>	<b>5 (pikë)</b>
<i>A janë përcaktuar qartë nevojat e tyre dhe a i adreson propozimi në mënyrë të përshtatshme?</i>	<b>5(pike)</b>
<b>3. Projektimi i veprimit</b>	<b>Referenca: Kap. 4 dhe 5</b>



<i>Sa koherent është modeli i përgjithshëm i veprimit? Në veçanti, a pasqyron ajo analizën e problemeve, të marrë parasysh faktorët e jashtëm dhe palët e interesuara përkatëse?</i>	<b>10 (pikë)</b>
<i>A është veprimi i realizueshëm dhe i qëndrueshëm në lidhje me objektivat dhe rezultatet e pritura?</i>	<b>10 (pikë)</b>
<b>4. Efektiviteti dhe realizueshmëria e propozimit</b>	<b>Referenca: Kap. 5 dhe 7</b>
<i>A sjell risi në adresimin e problemit modeli i propozuar nga aplikanti? ?</i>	<b>10 (pikë)</b>
<i>A është i qartë dhe i realizueshëm plani i veprimit dhe a janë paraqitur indikatorët mbi të cilët do vlerësohet përmbushja e objektivit të propozimit?</i>	<b>10 (pikë)</b>
<b>5. Buxheti dhe efektiviteti i kostos</b>	<b>Referenca: Kap.6</b>
<i>A janë pasqyruar në mënyrë efektive kostot e aktiviteteve në buxhetin e propozuar?</i>	<b>10 (pikë)</b>
<i>A është racional raporti midis kostove dhe rezultateve të pritura?</i>  <i>*Investimet e parashikuara do të jenë subjekt vlerësimi të detajuar dhe miratimi vetëm nga ana e Co-Plan.</i>	<b>10 (pikë)</b>
<b>6. Qëndrueshmëria e rrjetit</b>	<b>Referenca: Kap.4</b>
<i>A është ndërtuar strategjikisht mirë rrjeti? Ka të ngjarë që rrjeti të kthehet në një model suksesi dhe të ndërtojë/krijojë legjitimitet?</i>	<b>5 (pikë)</b>
<b>7. Komponenti gjinor</b>	
<i>A ka marrë aplikanti në konsideratë apo trajtuar elementin gjinor në projekt-propozim në raport me tematikën e parashtruar?</i>	<b>5 (pikë)</b>
<b>PIKËT TOTALE MAKSIMALE</b>	<b>100 (pikë)</b>

Aplikimet të cilat kanë arritur të akumulojnë **të paktën 70 pikë** do të konsiderohen të para-kualifikuar për fazën përfundimtare të përzgjedhjes së aplikimit fitues.

Në rast se, nga procesi i vlerësimit, rezultojnë më tepër aplikues të para-kualifikuar se sa mundësia e programit për të dhënë mbështetje financiare (grante) dhe hipotetikusht këto aplikime janë të gjitha me 70 apo më shumë pikë, atëherë Autoriteti Kontraktues do të aplikojë kriteret e paraqitura më poshtë:

- Fillimisht do të aplikohet kriteri i renditjes sipas pikëve të akumuluar, aplikanti i cili ka akumuluar më tepër pikë (minimalisht 1 pikë diferencë) do të konsiderohet fitues;
- Së dyti, në rast balotazhi (pikë të barabarta apo diferencë me presje dhjetore ndërmjet aplikantëve) do të zhvillohet një dëgjese me kandidatët potencial përpara Komisionit të Vlerësimit, të cilët më pas do të japin edhe vendimin përfundimtar.

### 6.3 Procedura e përzgjedhjes

Në përfundim të zhvillimit të procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues do të njoftojë të gjithë aplikantët me shkrim për vendimin e Komisionit Vlerësues në lidhje me aplikimet e dorëzuara. Në letrën përcjellëse për njoftimin e rezultatit do të paraqiten pikët e grumbulluara (mesatare e vlerësimit e të gjitha vlerësimeve nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit) nga aplikanti sipas formatit të vlerësimit. Kjo letër do të dërgohet e skanuar me e-mail drejt aplikantit lider të partneritetit.

Aplikantët të cilët besojnë se janë vlerësuar negativisht si rezultat i ndonjë gabimi apo parregullsie gjatë procesit të vlerësimit mund të kryejnë një ankimim me shkrim, brenda 5 (pesë) ditëve (ditë pune) nga dita që kanë marrë njoftim për refuzim. Të gjitha ankesat do të shqyrtohen dhe përgjigja do të kthehet brenda 5 ditëve (ditë pune) nga paraqitja e ankimit.

Për të siguruar një mbulim sa më të gjerë të temave mjedisore, shpërndarje të drejtë të fondeve dhe mbulim të gjërë territorial, ritheksojmë se Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të përzgjedh ndërmjet aplikimeve të parakualifikuara në favor të një mbulimi të gjërë territorial dhe diversiteti të temave të trajtuara.

#### a. Njoftimi i vendimit të Autoritetit Kontraktues

Pas vendimit për dhënien e një nën-granti, Përfituesit do t'i ofrohet një marrëveshje e cila do të zyrtarizojë edhe marrdhënien kontraktuale ndërmjet palëve.

#### b. Kontraktimi:

Përpara nënshkrimit të kontratës, Co-PLAN (si përgjegjës për zbatimin e skemës së granteve) rezervon të drejtën për të negociuar me aplikuesin në mënyrë që të sigurojë efikasitetin maksimal për shpenzimet e parashikuara në kuadër të këtij projekti. Në këtë linjë, Co-PLAN mund ti sygjerojë aplikantëve fitues ndryshimet përkatëse në zërat e buxhetit për të qënë në linjë me parimet e përgjithshme të skemës së granteve.

#### c. Kontratat, raportimet dhe pagesat përfundimtare

Pagesa do të planifikohet në 3 faza kryesore:

- i. Përfituesit do të marrin paradhënie, 40% të shumës totale të grantit pas nënshkrimit të kontratës;
- ii. Pagesa e ndërmjetme prej 40% pas dorëzimit të raportit të parë të ndërmjetëm narrativ dhe financiar (deri në fund të muajit të 9-të nga nënshkrimi i kontratës); si dhe pasi të jete vërtetuar që kësti i pare është shpenzuar në masën 70%.
- iii. Pagesa përfundimtare (20%) do të transferohet pas miratimit të përditësimeve të raportit përfundimtar narrativ dhe financiar.

### KALENDAR INDIKATIV I PROCESIT

	Data	Ora
<i>Shpallja publike e Thirrjes për Projekt - Propozime</i>	<i>03/12/2021</i>	<i>16:00</i>
<i>Sesioni i informimit I (online)</i>	<i>16/12/2021</i>	<i>14:00</i>
<i>Data në të cilën publikohen sqarimet nga Autoriteti Kontraktues (pas sesionit të informimit)</i>	<i>22/12/2021</i>	<i>16:00</i>
<i>Afati i fundit kohor për t'i drejtuar pyetje sqaruese Autoritetit Kontraktues.</i>	<i>14/01/2022</i>	<i>16:00</i>
<i>Afati i fundit kohor për dërgimin e Aplikimeve</i>	<i>31/01/2022</i>	<i>16:00</i>
<i>Informimi i aplikantëve mbi marrjen e projekt propozimit Nr. Prot</i>	<i>3/2/2022</i>	<i>16:00</i>
<i>Vlerësimi administrativ i aplikimeve</i>	<i>10/2/2022</i>	<i>16:00</i>
<i>Vlerësimi përmbajtësor nga Komisioni i Vlerësimit</i>	<i>8/3/2022</i>	<i>16:00</i>
<i>Njoftimi i aplikanteve për rezultatin e aplikimeve</i>	<i>11/3/2022</i>	<i>16:00</i>
<i>Afati i fundit në dispozicion për ankimim</i>	<i>18/03/2022</i>	<i>16:00</i>
<i>Kthim pergjigje për ankimimet</i>	<i>25/03/2022</i>	<i>16:00</i>
<i>Ceremonia e firmosjes së granteve</i>	<i>31/03/2022</i>	<i>10:00</i>

### E rëndësishme:

Parandalimi dhe eliminimi i çdo ndërhyrjeje arbitrare dhe/apo favorizuese është prioritet për Co-PLAN dhe partnerët. Procesi do të jetë transparent dhe informacioni në të gjithë hapat e tij do të jetë lehtësisht i aksesueshëm dhe i shoqëruar nga sesione orientuese, ofruar nga partnerët e Green-AL.